



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 11-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më
31. 10. 2014 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Nehat Tërpeza, anëtar
3. Daut Azemi , anëtar
4. Agron Hajdini, anëtar
5. Arton Retkoceri, anëtar
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Burbuqe Fazliu, anëtar
8. Linda Shahini, anëtar
9. Xhevat Olluri, anëtar
10. Rizah Bajraktari, anëtar
11. Ukë Kryeziu, anëtar
12. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
13. Hajrije Salihu, anëtar
14. Blerim Gashi, anëtar
15. Albulena Gashi, anëtar
16. Florent Hoxha, anëtar
17. Petrit Kelmendi, anëtar
18. Ragip Zejnullahu, anëtar
19. Nazmi Krasniqi, anëtar
20. Enver Kozhani, anëtar
21. Feriz Hasani, anëtar
22. Ali Stublla, anëtar
23. Valbona Shillova, anëtar
24. Burbuqe Ilazi, anëtar
25. Vlora Buja, anëtar
26. Arben Bahtiri, anëtar
27. Edita Gashi, anëtar
28. Ramiz Qeriqi, anëtar
29. Zoran Çirkovic anëtar
30. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
2. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës për Komunitete
3. Shkelzen Hajdini, Drejtor DBF
4. Rasim Hasani, Drejtor i Arsimit
5. Remzi Mehmeti, DMSH
6. Avni Olluri, Drejtor, DGJK
7. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
8. Basri Hashani, Drejtor i DKRS
9. Fauz Xhemajli, Drejtor i administratës
10. Haset Sahiti, Drejtor i SHP
11. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
12. Vlora Krasniqi, zyra ligjore
13. Jeton Zymeri, zyra pronoro juridik
14. Sanije Haziri, përfaqësuese e OSBE-së
15. Përfaqësuesi i OJQ "Ballkan"
16. Alban Nuredini, Zëdhënës i Komunës
17. Përfaqësuesit e mediave
18. Naser Bytyqi- përkthyes, shqip-serbisht
19. Rifat Hoxha- përkthyes, shqip-serbisht

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezantojnë 30 anëtarë të Kuvendit nga gjithsejt 31 hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë dhe i kemi 11 pika të rendit të ditës mirëpo propozoj që rendi i ditës të plotësohet me një pikë si vijon:

Propozimi i Vendimit për dhënjen e pëlqimit për ndarjen e mjeteve BI-së në Lipjan si dhe propozimi i Vendimit për caktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare BI-së në Lipjan për mbulimin e shpenzimeve të varrimit.

Propozimi i KPF-se është që të hiqet pika e 8-të e rendit të ditës Shqyrtimi i propozim Vendimit për ndarjen e trollit-tokës në shfrytëzim Sinan H. Sopes nga Fshati Smallushë.

Para se të kalohet në aprovimin e rendit të ditës fjalën e kërkoi Florent Hoxha, i cili në emër të grupit parlamentar të PDK-së tha se ne kemi bërë një kërkesë për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit dhe kërkesa e jonë nuk është realizu dhe është dashtë që Kryesuesja e Kuvendit në bashkëpunim me Kryetarin të thërret mbledhjen e jashtëzakonshme.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese e Kuvendit tha se kërkoj nga ju z. Florent Hoxha që të respektoni Rregulloren e punës së Kuvendit në mënyrë që të kemi mundësi të aprovojmë rendin e ditës.

Nazmi Krasniqi, unë kam një shqetësim të madh e që edhe ju anëtarët e Kuvendit duhet të keni këtë shqetësim lidhur me shkeljet ligjore gjatë pranimit të kuadrove në arsim. Nëse nuk do të ketë mbledhje të jashtëzakonshme ne nuk kemi pse të rrim në mbledhje.

Petrit Kelmendi, unë propozoj që të vazhdohet me rendin e ditës por paraprakisht të caktohet data se kur do të mbahet mbledhja e jashtëzakonshme në të kundërtën ne nuk kemi qka të rrimë në mbledhje.

Xhevat Olluri, unë kam një propozim që pika e propozuar për plotësim të rendit të ditës mos të hyjë në rend dite për shumë arsye dhe propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhje tjetër nëse nuk është urgjente.

Floren Hoxha, ne kemi kërkuar diqka qka është e ligjeshme, dhe se qe një muaj nuk na jeni përgjegjur.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese Kuvendit, lidhur me kërkesën e juaj do të merrni përgjigje pas aprovimit të rendit të ditës.

Me që anëtarët e PDK-së ishin këmbëngulës që së pari të caktohet data për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme e pastaj të kalohet në aprovimin e rendit të ditës dhe me që kjo nuk ndodhi në shenjë paknaqësie për mos përgjigje të menjëhershme grupi parlamentar i PDK-së lëshoi mbledhjen në ora 10³⁰.

Ramiz Qeriqi, unë kam dy propozime si vijon: e para të hiqen kazinot dhe e dyta të caktohet një lokacion për muze ku do të vendosen shenjat e luftëtarëve nga luftat e mëhershme dhe nga lufta e fundit.

Pastaj Kryesuesja lexoi rendin e ditës së propozuar së bashku me ndryshimet dhe plotësimet te cekura më lartë dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për asnjë kundër miratoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 9(e jashtëzakonshme) dhe mbledhja e 10-të e KK-së
2. Shqyrtimi i raporti të Buxhetit të alokuar për nëntë mujor dhe shpenzimi i mjeteve buxhetore për periudhen prej 01. 01. 2014 – 30. 09. 2014.
3. Shqyrtimi i propozim Vendimit për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2014.
4. Shqyrtimi i propozim Rregullores për bashkëpunimin e Komunës dhe organizimin e fshatrave, vendbanimeve dhe logjeve urbane.
5. Shqyrtimi i propozim Rregullores për ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taxi 15Nr. 011-27942 e dates 21. 07. 2014.
6. Shqyrtimi i propozim Vendimit për miratimin e planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2015.
7. Shqyrtimi i propozim Vendimit paraprak për dhënjen në shfrytëzim afatëshkurtur të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës
8. Shqyrtimi i propozim Vendimit për themelimin e Komitetit Konsultativ për Kulturë, Rini dhe Sport.
9. Shqyrtimi i propozim Vendimit për shpalljen e konkursit për anëtarësim në Komitetin konsultativ për Kulturë, Rini dhe Sport.
10. Shqyrtimi i propozim Vendimit për formimin e panelit përzgjedhës për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarësim në Komitetin Konsultativ për Kulturë, Rini dhe Sport.
11. Shqyrtimi i propozim Vendimit për dhënjen e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islamle në Lipjan dhe propozimi i Vendimit për caktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare BI në Lipjan për mbulimin e shpenzimeve të varrimit.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, pyeti se para se të kalojmë në shqyrtimin e pikave të rendit të ditës a ka dikush të thotë diqka.

Daut Azemi, dashta me ngritë një qështje që ka të bëjë me emërtimin e rrugëve e që kam vërejtë se është shqetësim te disa qytetarë ku kanë parashtruar edhe ankesa dhe kërkoj që ekzekutivi të na njoftoj lidhur me veprimet që janë ndërmarë lidhur me këto ankesa

Ramiz Qeriqi, para se të aprovohet rendi i ditës kam dy informata se Kryetari i Komunës ka marrë dy mirënjuhje një prej USAIDIT si menaxher i mirë dhe një prej shoqatës së invalidëve të luftës për ndërtimin e një shtepie në Bincë dhe uroj Kryetarin për këto mirënjuhje.

Hajrije Salihu, kam vërejtje te emërtimi i rrugëve me që emërat që kam propozuar unë janë

shenuar gabimisht si shembull rruga Myzaqete Begolli a në realitet është Nezaqete Begolli – Regjiqi e gjithashtu te rruga e shenuar Avdi Avdiu duhet ti shtohet Dr. përpara pasi ka qenë mjeku i parë.

Edita Gashi, kërkoj që të intervenohet në rregullimin e kanalizimit në Babush te rruga e Xhamisë me që aty është mbyllë kanalizimi.

Fitim Selimi, Nënkryetar i Komunës, më vjenë keqë që një numër i anëtarëve të Kuvendit e lëshuan mbledhjen dhe na kemi pasë dy kërkesa për mbledhjen e jashtëzakonshme dhe dihet se është mbajtur ajo mbledhje por kolegët që lëshuan mbledhjen nuk kanë ndejtë në atë mbledhje për të shqyrtuar pikat për mbledhjen e jashtëzakonshme.

Sa i përket emërimit të rrugëve është e vërtetë se ka gabime dhe paknaqësi te qytetarët ku kanë parashtruar edhe ankesa dhe ne jemi duke grumbulluar vërejtjet e qytetarëve dhe aty ku janë bërë gabimet kërkoj që sëpaku mos të vehen tabelat dhe në të ardhmen do të shqyrtojmë ato vërejtje me që në vendimet e Kuvendit askush nuk mund të ndërhyjë qoftë edhe për ndryshimin e një gabimi me një “ë”.

Vlora Limani- Hajnuni, Kryesuese e Kuvendit, unë kam pasur një kërkesë nga një e treta e deputetëve dhe unë e kam thirrë mbledhjen e jashtëzakonshme sipas asaj kërkesë dhe ky grup parlamentar e ka lëshuar mbledhjen kinse e kam ndryshuar rendin e ditës ku ata kanë thënë shkeljet ligjore a dihet se Kuvendi nuk trajton shkeljet ligjore por shkeljet procedurale.

Pastaj tha se që nga fillimi i punës së këtij mandati të Kuvendi ka bojkotime nga ky grup parlamentar ku në fillim kanë thënë se ka shkelje në formimin e Komiteteve ku nuk është respektu përqindja e numrit të përfaqësimit në Kuvend gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Komitetit etj.

Ramiz Qeriqi, unë e kamë nënshkruar kërkesën për mbledhjen e jashtëzakonshme dhe u kam thënë PDK-së se do t'i nënshkruaj kërkesat por unë nuk do ta lëshoj mbledhjen edhe pse ata e lëshuan.

I

Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 9(e jashtëzakonshme) dhe mbledhja e 10-të e KK-së

Edita Gashi, kam vërejtje në ekstraktë edhe pse po mundohem të kuptoj hartuesin se nuk mundet me shkruar pikë për pikë por te Rregullorja e tatimit në pronë thuhet se kam kërkur që të shtohet një nen ku lirohen nga tatimi disa kategori. Po kështu kam thënë por ta bëj të qartë se ka qenë për kategoritë e dalura nga lufta duke u bazuar në Ligjin përkatës të tyre.

Me që vërejtje të tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për asnjë kundër aprovoi ekstraktet ,

Aprovoi

Ekstraktet nga mbledhja e 9(e jashtëzakonshme) dhe mbledhja e 10-të e KK-së me vërejtjet e Editë Gashit

Shtesë: Ekstraktet.

II

Shqyrtimi i raporti të Buxhetit të alokuar për nëntë mujor dhe shpenzimi i mjeteve buxhetore për periudhën prej 01. 01. 2014 – 30. 09. 2014

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni. i dha fjalën Shkelzen Hajdinit Drejtor i DBF-së i cili në vazhdim përmes kinoprojektorit njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti i cili është pjesë përbërse e këtij procesverballi.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Daut Azemi, falenderoj Drejtorin për paraqitjen e raportit dhe ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar këtë raport dhe jemi të knaqur me realizimin e buxhetit duke ditur se ka qenë një vit i rëndë financiar siqë e ceku edhe Drejtori.

Blerim Gashi, ne e kemi shqyrtu këtë planifikim të buxhetit dhe po shifet se më heret ka pasur boshlyk në realizimin e të hyrave vetanake dhe me hjekjen e disa taksave për biznese kemi thënë se nuk kemi me mund me i realizu të hyrat vetanake por po shihet se me angazhim është arritë realizimi i të hyrave. Në vazhdim tha se duhet të angazhohemi më tepër në realizimin e mjeteve të granteve qeveritare.

Shqetësim tjetër për mua është rritja e pagave a në anën tjetër buxheti është zvogëlu prej 15% andaj pyes Drejtorin se a do të ketë mundësi të paguhen pagat.

Xhevat Olluri, unë e përgëzoj Drejtorin dhe Kryetarin e Komunës për punën që kanë bërë. Të hyrat vetanake edhe nëse nuk mund t'i shpenzojm deri në fund të vitit ato mund t'i bartim në vitin tjetër.

Shkelzen Hajdini, faleminderit për përgëzime dhe unë ju njoftova për shpenzimet për 9 muaj kurse tani gjendja është tjetër. Rreth pagave është shqetësim dhe Komuna nuk mund t'i paguaj me që rritja e pagave është me vendim të qeverisë dhe qeveria duhet me i paguar dhe gjerë me tani i ka paguar. Shqetësim tjetër është kontrata kolektive e cila kap shumen prej 1.5 milion euro kurse na i kemi planifiku a qeveria nuk ka qitë mjete për këto.

Me që diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja vuri në votim raportin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për 1 apstenim aprovoi

Aprovoi

Raportin e Buxhetit të alokuar për nëntë muaj dhe shpenzimi i mjeteve buxhetore për periudhën prej 01. 01. 2014 – 30. 09. 2014

Shtesë: Raporti.

III

Shqyrtimi i propozim Vendimit për rritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2014.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, tha se ky propozim Vendim është shqyrtu edhe në KPF dhe ky Vendim është nxjerrë për shkak të kanalizimit në fshatin Kojskë dhe 50 mijë euro tjera hiqen nga kodi për bashkëfinancim me donatorë dhe qiten në zyrën e Kryetarit në pozicionin për subvencione transfer. Pastaj i dha fjalën Shkelzen Hajdinit Drejtor i DBF-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me propozimin e Vendimit duke shtuar se 5.990,90 euro janë parapa për kanalizimin e fshatit Kojskë.

Xhevat Olluri, në KPF kemi sygjëru që 50 mijë euro me kalu në pozicionin për subvencione dhe transfere ku është parapa bashkëpunimi me donatorë dhe ky destinim është për ndërtimin e shtëpive. Pastaj tha që të formohet një komision prej 7 anëtarëve dhe ate 3 nga Kuvendi, 3 nga ekzekutivi 1 nga shoqëria civile ku do të shpallet konkursi dhe të parashihen kriteret për ata që konkurojnë në mënyrë që kjo punë të bëhet transparente se Komuna po ndërton shtëpi për raste sociale.

Agron Hajdini, tha se si grup parlamentar i LDK-së propozojmë që shuma prej 50 mijë euro të shkoj për qështje sociale dhe besoj se Drejtoritë respektive do ta kryejnë këtë punë dhe mendoj se nuk ka nevoj të formojmë komision me që Drejtoritë i kanë të identifikuar në teren rastet sociale.

Hajrij Salihu, si grup parlamentar e përkrahim këtë shumë prej 50 mijë euro për ndërtim të shtëpive e gjithashtu e përkrahim propozimin e Xhevatit për formim të komisionit sipas përbërjes që e propozoj.

Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës tha se nëse aprovohet që shuma prej 50 mijë euro të kalohet në subvencione dhe besoj se ju e dini që shuma se sa mund të ipen është e caktuar me Rregullore dhe nëse formohet komisioni që u propozu unë nuk besoj se në këtë vitë mund të realizohen këto mjete.

Blerim Gashi, unë nuk e di se për qka po ndahen këto mjete se në KPF- kemi thënë për raste sociale kurse tani po flitet për ndërtim, andaj kërkoj të di se këto mjete a shkojnë në zyrën e Kryetarit apo në Drejtoratin për qështje sociale.

Daut Azemi, ne si grup parlamentar kemi mendu se rast social është edhe ndërtimi i shtëpisë ndokujt që është i pastrehë dhe propozoj që këto mjete duhet të shpenzohen dhe dihet se me Rregullore mund të i ndaj deri në 2 mijë euro Kryetari dhe mbi këtë shumë duhet të vendos Kuvendi.

Vlora Limani-Hajnuni, formimi i komisionit mos po është dualizëm dhe cilat janë detyrat e këtij komisioni.

Fauz Xhemajli, unë nuk dua me gjykua iden e formimit të komisionit me që na i dimë kërkesat të cilat janë të shumta dhe janë duke pritur që t'u ndihmohet para stinës së dimrit dhe këto 50 mijë euro sado pak do ta zbusin situatën.

Ukë Kryeziu, këtë që e tha profesori dashta të them edhe unë mirëpo kërkoj që të jenë të barabart të gjithë ata që konkurojnë. Krejt theksi është që të mos diskriminojmë dikend dhe komisioni besoj se sigurisht do t'i rregulloj këto qështje.

Ahmet Maksuti, zyrtar ligjor, nuk e kam të qartë që mjetet që barten a janë në pozicion tjetër apo në pozicion ekzistues se këtu po përmendet ndërtimi i shtëpive e që kjo është në kundërshtim me Rregulloren për subvencione. U përmend që komisioni për dhënjën në shfytëzim të pronës së Komunës a unë mendoj se ky komision nuk mund të merret me këto mjete.

Vlora Limani-Hajnuni, ndoshta është mirë që këto mjete që janë propozu në shumë prej 50 mijë euro të barten në pozicione për subvencione.

Arben Bahtiri, nëse kërkohet të formohet ky komision atëher ato subvencione që i ka ndarë Kryetari është dashtë me pasur komision. Ne asgjë spo bëjmë vetëm po i bartim këto mjete për subvencion te zyra e Kryetarit bile unë në KPF kam kërkuar që një pjesë të këtyre mjeteve të shkoj në Kulturë, Rini dhe Sport.

Vlora Limani-Hajnuni, propozoj që të aprovohet shuma e propozuar e mjeteve për subvencione a sa i përket formimit të komisionit të shofim më vonë.

Ukë Kryeziu, mendoj se duhet t'i ndajmë këto mjete dhe të përcaktohem se a po i destinojm për ndërtim apo vetëm po i bartim në pozicionin për subvencione e që më vonë na nuk mund të ndikojmë.

Ramiz Qeriqi, u tha se KPF-ja ka propozu ndarjen e këtyre mjeteve për ndihmë sociale, mirëpo unë propozoj që këto mjete të destinohen ekskluzivisht për ndërtim të shtëpive për raste sociale dhe të formohet komisioni.

Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës tha se jemi pajtu që këto mjete të kalojnë në subvencione e nëse më vonë doni që këto mjete të përdoren për ndërtim atëherë i orjentojm për ndërtim e që sigurisht mund të ndërtojmë 3 shtëpi.

Blerim Gashi, ne jemi për me rritë transparencën por kur e ngitim dorën duam me ditë për qka, gjithashtu kërkoj që në mbledhjen le ardhshme duhet të kemi informatën se kush ka përfitu nga këto mjete. Unë jam kundër që këto mjete të shfrytëzohen për ndërtim të shtëpive.

Vlora Limani-Hajnuni, kush është për aprovimin e këtij vendim me ndryshimet dhe plotësimet që 50 mijë euro të barten në pozicionin për subvencione dhe 5.990,90 euro për kanalizim në fshatin Kojskë.

Pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 për 1 kundër miratoi këtë:

VENDIM
PËR RRYTJEN E BUXHETIT TE KOMUNËS SË LIPJANIT NGA TEJKALIMI I TË HYRAVE
VETANAKE PËR VITIN 2014

Neni 1.

Me këtë Propozim Vendim të bëhet rritja e planifikimit të buxhetit të hyrave vetanake në shumë prej 320,000.00€ .Kështu që shuma e planifikuar nga 1,166,927,00€ rritet në 1,486,927.00€.

Neni 2.

Mjetet nga Neni 1 i këtij Vendimi planifikohen (destinohen) si vijon:

Investime Kapitale:

Drejtorati për Sherbime Publike dhe MCE (18163)

Bashkëfinancim me donatorë –kodi i projektit (89240).....	40,000.00
Rehabilitimi i kanalizimeve në Kraishtë,Ribar i Madh Ribar i Vogel,Poturovc Torinë, Dobrajë e Madhe ,Llugë faza I-kodi i projektit (84570).....	9,500.00
Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në qytet -kodi i projektit (89242).....	3,097.73
Rregullimi i kanalizimit fekal në fshatin Lluge -kodi i projektit (89234).....	1,542.45
Rregullimi i kanalizimit fekal në fshatin Kojškë -kodi i projektit (89233).....	5,990.90
Gjithësejt shuma në investime kapitale.....	60,131.08

Mallra dhe sherbime:

Zyra e Kryetarit 160 (16003).....	11,859.82
Administratë 163 (16303).....	92,009.10
Sherbime Publike dhe MCE 180 (18163).....	89,000.00
Buxhet dhe Financa 175 (17515).....	7,000.00
Kulturë, Rini dhe Sport 850 (85015).....	10,000.00
Gjithësejt shuma në Mallra dhe Sherbime.....	209,868.92

Subvencione dhe Transfere:

Zyra e Kryetarit 160 (16003).....	50,000.00
-----------------------------------	-----------

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa

Neni 4.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Neni 5.

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë:Vendimi.

Pas përfundimit të kësaj pike në ora 12²⁰ u dha pauzë deri në ora 13²⁰.
Pas pauzës në ora 14⁰⁰ Kuvendi vazhdoi punën sipas pikës së katër.

IV

Shqyrtimi i propozim Rregullores për bashkëpunimin e Komunës dhe organizimin e fshatrave, vendbanimeve dhe logjeve urbane.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni tha se kemi pasur një Rregullore që ka qenë pak e vështirë për t'u zbatuar e gjithashtu kemi pasur rekomandimin nga MAPL për ndryshim të kësaj Rregullore, andaj edhe e kemi propozu këtë Rregullore. Në vazhdim i dha fjalën Fauz Xhemajlit Drejtor i DA-së i cili njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Rregullorja duke shtuar se te neni 29 i Rregullores duhet të ndryshohet dhe thuhet se kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së si dhe publikimin në gjuhën zyrtare në web faqën e Komunës.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, Drejtori e ceku ndryshimin në nenin 29 të Rregullores, andaj hapi shqyrtimin.

Ukë Kryeziu, kjo Rregullore ka rëndësi të veçantë dhe qytetarët e mirëpresin këtë Rregullore me që Rregullorja e kaluar ka disa mangësi mirëpo edhe me këtë propozim Rregullore disa qështje nuk janë në rregull si qështja e tubimit të qytetarëve që jua cenon të drejtën të tjerëve të marrin pjesë në zgjedhje. Pastaj edhe qështja e dorëheqjes së një anëtarit të Këshillit ku kërkohet njejtë zgjedhje për zëvendësimin e tij. Nuk duhet me qenë që këshilli ta zgjedh Kryetarin por Kryetarë të zgjedhet ai që ka fituar më së shumti vota, ndërsa sa i përket qështjes së pagesës së pagës për Kryetarin e fshatit është shumë mirë.

Krejt çka deshta të them është se kjo propozim Rregullore ka nevojë për ndryshime substanciale.

Vlora Limani, Kryesuese, në mënyrë të thënë se organizimi i zgjedhjeve në fshatra është sikur zgjedhje të pushtetit të tretë a dihet se ne nuk kemi tri nivele të zgjedhjeve. Pastaj tha se ju e keni rregulloren e punës së Kuvendit dhe kërkoi që ti përmbaheni rregullores dhe propozimet ti dërgoni me shkrim për gjdo akt.

Daut Azemi, unë mendoj se kjo rregullore do të jetë më demokratike për qytetar dhe me këtë rregullore nuk do të ketë garë të subjekteve politike por do të zgjedhen përfaqësuesit e popullit dhe zgjedhjet do të bëhen në mënyrë të hapur e jo të votohet në kuti.

Xhevat Olluri, parimisht unë jam që këto zgjedhje të jenë të nivelit të tretë të pushtetit por kjo nuk varet prej neve. Unë jam që zgjedhjet në fshatra të bëhen me vota të fshehta përmes kutis, por as këtë nuk mund ta bëjmë ne por këtë mund ta bëjë KQZ-ja. Ne po flasim për forumin a nuk e dim se sa duhet të jetë kuorumi ku thuhet se trefishi i atyre që zgjedhen duhet të jenë prezent në tubim dhe gjithashtu tha duhet të njoftohet gjdo familje për mbajtjen e tubimit për zgjedhjen e këshillit të fshatit.

Blerim Gashi, Rregullorja e kaluar ka pasur mangësit dhe vështësit në implementimin e saj.

Pastaj tha se institucionet e reja që do të formohen besoj se do të nxjerrin edhe Ligjin për zgjedhje në fshatra. Te kuorumi na nuk e dim se sa duhet të jenë për kuorum por kuorumi duhet të përcaktohet në masë ashtu siqë e tha profesori trefishi i atyre që zgjedhen.

Ukë Kryeziu, unë e lavdova Rregulloren në ato pjesë që janë të mira, por në këtë Rregullore po thuhet se trefishi që zgjedhen duhet të është kuorumi, atëherë çka mund të ndodhë kur tubohen 10-15 vetë dhe e zgjedhin këshillin e fshatit dhe kjo ndoshta në fshatrat e vogla mund të bëhet por në fshatra të mëdha është e pamundur që zgjedhjet të organizohen në këtë mënyrë me që ka mundësi që të njejtën ditë të mbahen 2-3 tubime.

Daut Azemi, unë e thash se i kam parë disa Rregullore të Komunave tjera të cilat janë të ngjajshme me këtë Rregullore. Në zgjedhjet e kaluara është qitë kutija dhe është shënuar emëri i jemë se kam votuar pa votuar fare.

Fauz Xhemajli, këtu u paraqitën disa qështje e sidomos u përmend kuorumi dhe unë besoj se do të marrin pjesë në zgjedhje shumë qytetarë e gjithashtu u tha se as me Ligjin për zgjedhjet

nuk është parapa përqindja. Në vazhdim tha se nuk është e ndaluar që votimi mos të bëhet në mënyrë të fshehtë e gjithashtu u tha se këshilli ka kompetencë më të madhe se Kryetari i këshillit.

Hajrije Salihu, në Rregulloren e re ka disa mangësi, andaj propozoj që kjo Rregullore të shtyhet dhe plotësohet.

Xhevat Olluri, në Ligjin mbi zgjedhjet nuk ka fjalë kuorum, andaj ose të fshihet neni 12 i kësaj Rregullore ose të caktohet me përqindje.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, unë mendoj se te neni 12 duhet të ndërhyjm dhe ta formulojmë si vijon: kuorumin e përbëjnë jo më pak se 5% të qytetarëve me të drejtë vote. Gjithashtu tha se te neni 29 të bëhet ndryshimi sipas asaj që e ceka në fillim për hyrjen në fuqi të Rregullores.

Pastaj vuri në votim Rregulloren me propozimet për ndryshim te neni 12 dhe neni 29 dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për aprovoi:

Rregulloren

Për bashkëpunimin e Komunës dhe organizimin e fshatrave, vendbanimeve dhe logjeve urbane.

Shtesë: Rregullorja.

Pas përfundimit të pikës së katër Kryesuesja konstatoi se nuk ka kuorum për punë dhe ndërpreu mbledhjen duke shtuar se përveq Editës që më ka pyetur askush nuk ka arsye që ka lëshuar mbledhjen.

Për shqyrtimin e pikave tjera do të njoftoheni.

Mbledhja u ndërpre në ora 15,⁰⁰

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni

E K S T R A K T

Nga vazhdimi i mbledhjes së 11-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 06. 11. 2014 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Nehat Tërpeza, anëtar
3. Daut Azemi , anëtar
4. Agron Hajdini, anëtar
5. Arton Retkoceri, anëtar
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Burbuqe Fazliu, anëtar
8. Linda Shahini, anëtar
9. Xhevat Olluri, anëtar
10. Rizah Bajraktari, anëtar
11. Ukë Kryeziu, anëtar
12. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
13. Hajrije Salihu, anëtar

14. Blerim Gashi,	anëtar
15. Albulena Gashi,	anëtar
16. Arben Bahtiri,	anëtar
17. Edita Gashi,	anëtar
18. Ramiz Qeriqi,	anëtar
19. Zoran Çirkovic	anëtar
20. Xhavid Maholli,	anëtar

Të tjerë prezent:

1. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
2. Rasim Hasani, Drejtor i Arsimit
3. Remzi Mehmeti, DMSH
4. Avni Olluri, Drejtor, DGJK
5. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
6. Basri Hashani, Drejtor i DKRS
7. Fauz Xhemajli, Drejtor i administratës
8. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
9. Feti Krasniqi, Drejtor BPZHR
10. Imer Rrustemi, Drejtor DI
11. Vlorë Krasniqi, zyra ligjore
12. Lumniqe Ejupi, zyra pronoro juridik
13. Jeton Zymeri, zyra pronoro juridik
14. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
15. Përfaqësuesi i OJQ "Ballkan"
16. Alban Nuredini, Zëdhënës i Komunës
17. Përfaqësuesit e mediave
18. Naser Bytyqi- përkthyes, shqip-serbisht
19. Rifat Hoxha- përkthyes, shqip-serbisht

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Kryesuesja e Kuvendit Vlorë Limani-Hajnuni pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 20 anëtarë të Kuvendit dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se siqë e dini edhe ju kjo është vazhdim i mbledhjes dhe propozoj që të kalojmë në punë sipas pikës së 5-të të rendit të ditës së aprovuar.

V

Shqyrtimi i propozim Rregullores për ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taxi 15Nr. 011-27942 e dates 21. 07. 2014.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlorë Limani-Hajnuni tha se në mungesë të Drejtorit të Drejtoratit për Shërbime Publike i jap fjalën Drejtorit të Drejtoris së Administratës Fauz Xhemajli i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit lidhur me procedurat e hartimit të propozim Rregullores për ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores për transportin e udhëtarëve si dhe me të dhënat nga propozim Rregullorja e cila është pjesë përbërse e këtij procesverballi.

Pasta Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Nehat Tërpeza, propozimi i Rregullores është diskutuar edhe në grupin parlamentar të LDK-së dhe ne i përkrahim ndryshimet të cilat janë bërë në këtë Rregullore. Në vazhdim tha se ndryshimet janë në paragrafin 7 si dhe neni 26 dhe 27 fshihet nga Rregullorja.

Edita Gashi, këtë Rregullore Kuvendi e ka aprovu me 17 shkurt dhe ndryshimet që duhet bërë në të njejtën Rregullore shihet se organet komunale nuk e kanë hartuar në mënyrë profesionale.

Blerim Gashi, na e kemi shqyrtu edhe në KPF këtë Rregullore dhe nuk kemi pasur ndonjë ndryshim. Në këtë Rregullore është një defekt në nenin 9 dhe mendoj se pjesa e dytë në këtë nen nuk duhet të ekzistoj si nen i veçant.

Ukë Kryeziu, edhe ne si grup asambleist i japim mbështetje këtij ndryshimi të Rregullores për transportin e udhëtarëve me që edhe për këtë jemi këtu.

Zoran Çirkoviç, ne si komunitet serb në Grackë të vjetër e kemi një kombi bus për transport të udhëtarëve në relacionin Grackë –Graqanicë dhe kërkesa jonë është që t'i lëshohet leja për qarkullimin tranzit të këtij automjeti nëpër Lipjan.

Vlora Limani-Hajnuni, ne jemi për ta rregulluar këtë qështje por procedurat i bën Drejtorati i Shërbimeve Publike.

Me që diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja vuri në votim propozimin e Rregullores dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për 1 kundër miratoi këtë:

Rregullore

**Për ndryshimet dhe plotesimet e Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taxi
15Nr. 011-27942 e dates 21. 07. 2014.**

Shtesë: Rregullorja.

VI

Shqyrtimi i propozim Vendimit për miratimin e planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2015

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi duke shtuar se kemi një kërkesë nga Edita Gashi ku propozon që me plan të përfshihet mbledhja solemne me 28 Nëntor Dita e Flamurit dhe një mbledhje solemne me rastin e 8 marsit festës së gruas e gjithashtu edhe 2 mbledhje në vit për sektorin e bujqësisë. Në vazhdim tha se për mbledhje solemne MAPL-ja ka thënë nuk ka nevojë të parashihen në planin e punës.

Edita Gashi, nëse MAPL ka thënë se nuk ka nevojë të parashihen në plan mbledhjet solemne atëherë është në rregull.

Ramiz Qeriqi, e përkrahu Editën që me 28 Nëntor të festohet dita e flamurit e gjithashtu me 14 qershor dita e dëshmorëve.

Daut Azemi, ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Vendim dhe mendoj se në plan të punës duhet të parashihen vetëm seancat e punës kurse seancat solemne si Kuvend mund t'i organizojmë kur të dojmë.

Hajrije Salihu, edhe na si grup parlamentar e përkrahim këtë plan të punës.

Vlora Limani-Hajnuni, në këtë plan ka ndryshime ku duhet të hiqen mbledhjet solemne e gjithashtu parashihen 11 mbledhje mbrenda vitit kalendarik. Te kërkesa e Editës u kërkuar 2 mbledhje të Kuvendit duhet të thuhet 2 informata të Drejtoratit të bujqësisë të shqyrtohen në Kuvend.

Feti Krasniqi, na e kemi një plan orjentues të Drejtoratit të bujqësisë dhe Kuvendit i paraqesim informata.

Blerim Gashi, mua nuk më pëlqen ky formulim që Kuvendi të mbajë 11 mbledhje dhe kjo nuk është konform Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale me që ky Ligj thotë se Kuvendi mban minimumin 10 mbledhje e maksimumin 12, e nuk është dashtë që në planë të thuhet 11 mbledhje.

Me që diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit me plotësimet dhe ndryshimet e propozuara më lart dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për 1 kundër miratoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT ORIENTUES TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË
LIPJANIT PËR VITIN 2015

Neni 1

MIRATOHET Plani orientues i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2015.

Neni 2

Kuvendi i Komunës së Lipjanit planifikon t'i mbajë 11 mbledhje të rregullta dhe secilës mbledhje të rregullt të Kuvendit i paraprin mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 3

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të mbahen sipas periodës kohore si në tabelën në vijim:

Mbledhjet	Temat që do të diskutohen	Perioda mujore e mbajtjes
Mbledhja e parë	1.Raporti i Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare dhe zbatimin e planeve investuese të Komunës për periudhën Korrik – Dhjetor 2014. 2. Raporti vjetor i punës së i KK për vitin 2014	Janar
Mbledhja e dytë	1. Bartja (rialokimi) I buxhetit të pashpenzuar nga viti I kaluar në vitin aktual 2. Informat nga DKA mbi suksesin e arritur të nxënësve në Komunën e Lipjanit në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit akademik 2014/2015	Shkurt
Mbledhja e tretë	1.Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës për vitin 2014	Mars
Mbledhja e katërt	1.Raport tre mujore financiare të Komunës për periudhën Janar – Mars 2015.	Prill
Mbledhja e pestë	1.Raporti i Komiteteve Funkzionale. 2.Raporti i Punes i KKS-së	Maj
Mbledhja e gjashtë	1. Miratimi i Korrnizës Afatmesme Buxhetore 2016-2018 2. Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2015.	Qershor
Mbledhja e shtatë	1. Raporti i Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare dhe zbatimin e planeve investuese të Komunës për periudhën Janar – Qershor 2015 2. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komunës për periudhën Janar – Qershor 2015	Korrik

	3. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2014 4. Informatë nga DKA mbi suksesin e arritur të nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit akademik 2014/2015 5. Fillimi i përgatitjeve për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016. 6. Informate nga Drejtorati për bujqësi për korre shirjet në Komunën e Lipjanit.	
Mbledhja e tetë		Gusht
Mbledhja e nëntë	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2016 2. Informat nga DKA mbi fillimin e vitit të ri Shkollor 3. Rregullorja për tatimin në pronë . 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2016	Shtator
Mbledhja e dhjetë	1. Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës për periudhën Korrik – Shtator 2015.	Tetor
Mbledhja e njëmbdhjetë	1. Raport i Komisioneve. 2. Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike. 3. Informatë nga Drejtorati për bujqësi për të mbjellat në Komunën e Lipjanit. 4. Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale .	Nëntor
Mbledhja e dymbdhjetë	1. Informatë e Policisë për gjendjen e sigurisë në Komunë	Dhjetor

Neni 4

4.1 Kuvendi i Komunës, për shqyrtimin e çështjeve nga kompetenca e vet, të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave tjera ligjore, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit mban së paku dhjetë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.2 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe më shumë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.3 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne në rastet e caktuara me dispozitat e cekura ligjore.

Neni 5

Plani i mbledhjeve të Kuvendit, i përcaktuar si në nenin 3 të këtij Vendimi është orientues dhe do të mund të ketë ndryshime gjatë vitit.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokollit të MAPL-s dhe publikimin në gjuhët zyrtare në Webfaqen e Komunës

Shtesë: Vendimi

VII

Shqyrtimi i propozim Vendimit paraprak për dhënenë në shfrytëzim afatëshkurtur të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Drejtorit DEZH, Latif Ramadani i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, këtë Vendim ne e përshëndesim dhe paraprakisht Komuna ka identifikuar pronat e Komunës dhe me këtë Vendim rriten të hyrat vetanake të Komunës.

Xhevat Olluri, na heren e kaluar jemi marrë vesh që mos të jetë kontestuese ndonjë pronë apo lokal dhe propozoj që në Vendim të caktohet edhe çmimi fillestarë.

Merita Zeqiri-Hajrizi, ne e përkrahim këtë propozim Vendim e gjithashtu edhe propozimin e profesorit që në Vendim të caktohet çmimi fillestar.

Edita Gashi, propozoj që lokalet të ipen për 3 vite me mundësi të vazhdimit të kontratës.

Nehat Tërpeza, nuk pajtohem me propozimin e Editës që lokalet të ipen për 3 vite.

Merita Zeqiri-Hajrizi, në Rregullore thuhet se është e drejta e shfrytëzuesit të kontratës dhe nuk është e qartë se kjo e drejtë është vetëm për komunën apo edhe për qiramarrësin.

Arben Bahtiri, inkurajoj ekzekutivin për këtë propozim -vendim me që e dimë se ka raste kur lokalet që janë dhënë në shfrytëzim ka raste që disa lokale i shfrytëzon pala e tretë kështu që një lokal që ka dhënë Komuna për 400 euro qira ai shfrytëzues i ka dhënë dikujt tjetër për 1200 euro dhe me këtë Vendim sigurisht ndërpriten keqpërdorimet.

Ramiz Qeriqi, ata që kanë lokalet me qira dhe që i kanë përmbushë obligimet ndaj Komunës deri në 50% propozoj që t'u vazhdohet kontrata deri në 6 muaj.

Latif Ramadani, sa i përket çmimit dihet se këto shkojnë me ankand publik dhe kuptohet se ai që jep më shumë e fiton të drejtën në lokal.

Me që diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit me plotësimet dhe ndryshimet e propozuara më lart dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për 1 kundër miratoi këtë:

Shtesë: Vendimi.

Për pikën e 8 jemi marrë vesh që ta shtyjmë, andaj kalojmë në pikën e 9-të

IX

Shqyrtimi i propozim Vendimit për themelimin e Komitetit Konsultativ për Kulturë, Rini dhe Sport

Lidhur me këtë pikë me të dhënat nga propozimi i Vendimit të pranishmit i njoftoi Basri Hashani, Drejtor i DKRS.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Arben Bahtiri, me që tri pikat kanë të bëjnë me Vendimin e parë unë propozoj që këto pika të votohen në bllok. Unë e përkrahu këtë propozim Vendim dhe inkurajoj ekzekutivin që ka marrë këtë hap për themelimin e këtij Komiteti.

Pastaj për anëtarë të panelit propozoj Linda Shahinin.

Blerim Gashi, edhe ne e mbështesim këtë Vendim dhe mendoj se duhet të votohet për çdo Vendim veq e veq.

Me që diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit me plotësimet dhe ndryshimet e propozuara më lart dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për 1 apstenim miratoi këtë:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT KONSULTATIV PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Neni 1

Themelohet Komiteti Konsultativ për kulturë, rini dhe sport në përbërje prej 5 anëtarëve të përfaqësuar nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të cilët njëherit duhet të jenë njohës të çështjes nga lëmia e kulturës, rinisë dhe sportit.

Neni 2

Kuvendi shpall Konkurs për anëtarësim në këtë Komitet në pajtim me kriteret e përcaktuara me nenin 4 të Udhëzimit administrativ nr.2008/10 "Për organizimin dhe funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna" dhe nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 3

Kuvendi i Komunës themelon panelin përzgjedhës në përbërje prej tre anëtarëve, dy anëtarë nga përbërja e Kuvendit dhe një nga shoqëria civile për të zbatuar procedurën e Konkursit dhe t'i propozojë Kuvendit për miratim listën e anëtarëve të këtij Komiteti.

Neni 4

Komiteti do kryej detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me nenin 8 të Udhëzimit të cekur administrativ administrativ.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në Uebfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendimi.

X

Shqyrtimi i propozim Vendimit për shpalljen e konkursit për anëtarësim në Komitetin konsultativ për Kulturë,Rini dhe Sport.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Basri Hashani Drejtor i DKRS, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Me që diskutime rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për 1 apstenim miratoi këtë:

VENDIM

PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PËR ANËTARËSIM NË KOMITETIN KONSULTATIV PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Neni 1

Me këtë Vendim vendoset që të shpallet Konkursi për anëtarësim në Komitetin Konsultativ për Kulturë,Rini dhe Sport.

Neni 2

Konkursi të shpallet në Uebfaqen e Komunës dhe në dy gazeta ditore.

Neni 3

Punët administrative - juridike për shpalljen e konkursit dhe procedurave në vazhdim do t'i kryej Sektori për punë të Kuvendit dhe komiteteve në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimit administrativ nr.2008/10 "Për organizimin dhe funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna" dhe Statutit të Komunës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

XI

Shqyrtimi i propozim Vendimit për formimin e panelit përzgjedhës për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarësim në Komitetin Konsultativ për Kulturë, Rini dhe Sport

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Basri Hashani Drejtor i DKRS, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit duke shtuar se në këtë panel Kryetari nga shoqëria civile ka propozu Mergim Oruqin aktorë dhe 2 anëtarë tjerë të zgjedhen nga Kuvendi.

Vlora Limani-Hajnuni, nga LDK-ja u propozu më heret Linda Shahini dhe propozoj që kjo të jetë edhe Kryesuese e panelit.

Hajrije Salihu, propozoj Ukë Kryeziun.

Blerim Gashi, si po shifet na duhet ta rrisim numrin e anëtarëve në këtë Komitet me që u tha se dy anëtarë duhet të jenë nga dy partitë më të mëdha në Kuvend, a dihet se në Komitete PDK-ja nuk i ka dërguar anëtar.

Nehat Tërpeza, unë i përkrahu propozimet që në këtë panel të zgjedhen si vijon:

1. Linda Shahini, Kryesuese
2. Ukë Kryeziu, anëtar
3. Mergim Oruqi, anëtar

Me që diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit me propozimet për anëtarë të panelit të konstatuar më lartë dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për 1 apstenim miratoi këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E PANELIT PËRZGJEDHËS PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PËR ANËTARËSIM NË KOMITETIN KONSULTATIV PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Neni 1

Formohet paneli përzgjedhës për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët do të aplikojnë në Konkursin publik për anëtarësim në Komitetin Konsultativ për kulturë, rini dhe sport si vijon:

1. Linda Shahini, nga përbërja e Kuvendit- Kryesuese
2. Ukë Kryeziu, nga përbërja e Kuvendit
3. Mergim Oruqi, nga shoqëria civile

Neni 2

Detyrë e panelit përzgjedhës është që në pajtim të dispozitave ligjore dhe kriterëve të përcaktuara në Konkursin publik për anëtarësim në Komitetin Konsultativ të bëjë intervistimin e kandidatëve dhe ti propozojë Kuvendit të Komunës listën me anëtarët për Komitetin Konsultativ.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në Uebfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendimi.

XII

Shqyrtimi i propozim Vendimit për dhënjen e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan dhe propozimi i Vendimit për caktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare BI në Lipjan për mbulimin e shpenzimeve të varrimit.

Lidhur me këtë pikë me të dhënat nga propozim Vendimi të pranishmit i njoftoi Basri Hashani Drejtor i DKRS.

Vlora Lilmani-Hajnuni, këtu kemi dy propozim Vendime njëra është për ndarjen e 13 mijë euro për mbulimin e shpenzimeve të varrimit dhe propozim Vendimi tjetër është caktimi i çmimit në shumë prej 110 euro për një varrim.

Xhevat Olluri, mendoj se këto mjete nuk duhet të shkojnë në këtë mënyrë dhe propozoj që DSHP duhet të hap konkurs për këto shërbime në mënyrë që ndërmarrjet që kryejnë këto shërbime të konkurojnë dhe ato që janë më të lira të marrin këtë punë, ndoshta këto punë mund të bëjë edhe Bashkësia Islame por duhet të jetë e licencuar.

Nehat Tërpeza, na si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Vendim me që edhe më heret kemi aprovu Vendime të tilla ku kemi ndarë mjete financiare BI. Dhe kemi kërku që BI-ja të jetë më racionale,

Pastaj tha se kemi propozimin që shpenzimet për një varrim të caktohet çmimi 110 euro e jo si që ka qenë më i lartë më heret.

Blerim Gashi, edhe ne e përkrahim këtë propozim Vendim por brenga më e madhe është se tani për tani nuk ka mjete dhe shtrohet pyetja nga do të realizohet ky Vendim.

Propozimi për një varrim të jetë shuma prej 110 euro mendoj se është me vend.

Ramiz Qeriqi, unë jamë i mendimit që pagesa t'i bëhet drejtë përsëdrejti familjes, me që ka dikush që ka mjaft para dhe nuk i tërhekin këto mjete dhe ato mbesin në Bashkësi Islame.

Zoran Çirkoviç, e përkrahi parafolësin dhe propozimin që këto mjete t'i paguhen drejtpërsëdrejti familjes.

Arben Bahtiri, propozoj që nga BI të kërkohet raport se si janë shfrytëzuar mjetet që u janë ndarë.

Vlora Limani-Hajnuni, kemi dy propozime në Vendim ndarja e mjeteve për shërbimet e kryera si dhe propozimi për caktimin e çmimit në shumë prej 110 euro për një varrim për të ardhmen.

Ramiz Qeriqi, në të shumtën e rasteve familjet e kan hapur vet varrin dhe mjetet nuk ju kanë dhënë asaj familje nga BI.

Agron Hajdini, e përkrahi propozimin për caktimin e çmimit prej 110 euro për të ardhmen me që konsideroj se është me vend.

Xhavid Maholli, ne jemi duke bisedu për ndarjen e mjeteve e jo për procedurat se si ndahen mjetet pastaj, unë po lidhna me diskutimin e profesorit ku tha se këto punë i kryejnë ndërmarrjet e licencuara dhe në Prishtinë këto punë i kryen ndërmarrja Holti kultura dhe besoni se kjo ndërmarrje varrezat i ka hapur me kahje të ndryshme që neve si musliman nuk na takon dhe është e pa pranueshme.

Me që diskutime të tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimet e Vendimeve dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për miratoi këto:

V E N D I M
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME
NË LIPJAN

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan në shumë prej 13,200 €, (trembëdhjetë mijë e dyqind euro) për subvencionim të shpenzimeve të varrimeve, për 66 raste të vdekjes të cilat kanë ndodhur paraprakisht deri me datë 01.10.2014 me nga 200 Euro për secilin rast.

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të subvencionohet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2014.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Neni 4

Per zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

V E N D I M
PËR PËRCAKTIMIN E SHUMËS PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË
ISLAME NË LIPJAN PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

Me këtë Vendim përcaktohet që shuma e shpenzimeve të varrimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan, nga kategoria ekonomike e subvencioneve të jetë 110 € për shërbimet në vijim:

Nr.	LLOJI I SHËRBIMIT	Shuma
1.	Hapja e varrit (sipas parimeve fetare pa arkivol)	40 €
2.	Dërrasat (Dërrasat me të cilat mbulohet i vdekuri pas lëshimit në varr me dimensione 2.00x1.15x0.05)	35 €
3.	Qefini (mbështjellës I veçantë për kufomë sipas parimeve islame përfshihen dorëzat higjienike si dhe pambuku dhe sapuni)	15 €
4.	Piramida (Dërrasat me mbishkrimin e të dhënave të vdekurit)	20 €
	Gjithsej	110 €

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Neni 3

Per zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Shtesë: Vendimet.

Mbledhja përfundoi në ora 14⁰⁰

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni